

## **2010 Raporti Nderkombetar i Lirise Fetare (11 shtator 2011)**

### **SHQIPËRIA**

Kushtetuta dhe ligjet e politikat e tjera mbrojnë lirinë e fesë dhe qeveria në përgjithësi i zbatoi këto mbrojtje në praktikë.

Në përgjithësi qeveria e respektoi lirinë e fesë me ligj dhe në praktikë. Nuk pati ndryshime në statusin e respektimit të lirisë së fesë nga qeveria gjatë periudhës së raportimit.

Nuk pati raporte për abuzime shoqërore apo diskriminime mbi baza të përkatësisë fetare, besimit apo praktikimit të fesë.

Qeveria e SHBA diskuton lirinë e fesë me qeverinë si pjesë e politikës së saj të përgjithshme për të nxitur të drejtat e njeriut.

#### Seksioni I. Demografia Fetare

Vendi ka një sipërfaqe prej 28 748 km katrorë dhe popullsi prej 3.6 milionë banorësh. Nuk pati të dhëna të besueshme në lidhje me pjesëmarrjen dhe anëtarësinë fetare; regjistrimi i fundit zyrtar me të dhëna të tilla ishte kryer në vitin 1939. Shumica e shtetasve nuk praktikojnë aktivisht një besim të caktuar; megjithatë, katër grupimet tradicionale fetare janë muslimanët (sunitë), bektashinjtë (një formë e sufizmit shia), të krishterët ortodoksë (Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë) dhe katolikët romakë. Gjithashtu, ka shifra thelbësore të feve protestante dhe grupeve të tjera fetare, përfshirë Bahait, Dëshmitarët e Jehovahit dhe Kisha e Jezu Krishtit të Shenjtëve të Ditëve të Mëvonshme (mormonët).

Komiteti Shtetëror mbi Kultet raportoi mbi 230 grupime, organizata, fondacione dhe institucione fetare që veprojnë në vend.

#### Seksioni II. Statusi i Respektimit që i bën Qeveria Lirisë së Fesë

##### Kuadri Ligjor/Politikat

Ju lutemi shikoni Shtojcën C në Raportin e Vendit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për statusin e pranimit nga ana e qeverisë të standardeve ndërkombëtare ligjore <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2010/appendices/index.htm>.

Kushtetuta dhe ligjet e politikat e tjera ruajnë lirinë e fesë dhe në praktikë, qeveria në përgjithësi i zbatoi këto mbrojtje. Shtetasit kanë të drejtën të padisin qeverinë për cënim të lirisë së tyre për ushtrimin e fesë.

Vendi është shekullar me ligj. Sipas kushtetutës, nuk ka fe zyrtare dhe gjithë fetë janë të barabarta; megjithatë, muslimanët suni, bektashinjtë, ortodoksët dhe katolikët gëzojnë njohje më të gjerë (p.sh. në festa zyrtare) dhe status shoqëror bazuar mbi praninë e tyre historike në vend.

Më 4 shkurt, parlamenti miratoi një ligj të ri kundër diskriminimit. Ligji krijoi Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e cila do të marrë dhe përpunojë ankesat për

diskriminim. Në maj parlamenti emëroi një komisioner. Megjithatë, institucioni i ri kishte mangësi në fonde dhe staf të mjaftueshëm.

Qeveria nuk kërkon regjistrim apo licensim të grupeve fetare; megjithatë, Komiteti Shtetëror i Kulteve mban të dhëna dhe statistika mbi organizatat e huaja fetare të cilat kërkojnë ndihmën e tij. Lëvizjet fetare mund të fitojnë statusin zyrtar të personit juridik duke u regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë sipas Ligjit mbi Organizatat Jofitimprurëse, i cili njih statusin e një shoqate jofitimprurëse qoftë kjo e karakterit kulturor, argëtues, fetar apo humanitar. Regjistrimi u garanton grupimeve fetare të drejtën të mbajnë llogari bankare dhe të zotërojnë pronë, si edhe një nivel të caktuar status përjashtimi nga taksat. Katër komunitetet tradicionale fetare kanë nënshkruar marrëveshje me qeverinë në vitin 2008, të cilat u garantojnë atyre përjashtime më të gjera nga taksat dhe privilegje të tjera.

Neni 10 i kushtetutës kërkon marrëveshje të veçanta dypalëshe për të rregulluar marrëdhëniet mes qeverisë dhe komuniteteve fetare. Kisha Katolike ka pasur një marrëveshje të tillë me qeverinë që prej vitit 2002. Në vitin 2008 qeveria firmosi marrëveshje me komunitetet muslimane, ortodokse dhe bektashi. Qeveria firmosi marrëveshje dypalëshe me Vëllazërinë Evangjeliste të Shqipërisë (VUSH), organizatë protestante përmbledhëse, në 22 nëntor. Disa nga përparësitë e të pasurit marrëveshje janë njohja zyrtare e komunitetit, prioritet në kthimin e pronave dhe përjashtime nga taksat. Mbështetja financiare nga qeveria dhe paga të subvencionuara nga shteti për klerikët do të zbatoheshin bazuar në një ligj mbi financimin e komuniteteve fetare, miratuar në qershor të vitit 2009. Megjithatë, në praktikë ka pasur shumë pak progres në lidhje me kthimin e pronave fetare.

Komiteti Shtetëror i Kulteve, nën juridiksionin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, është i ngarkuar të rregullojë marrëdhëniet mes qeverisë dhe komuniteteve fetare, si edhe të mbrojë lirinë e fesë dhe nxisë bashkëveprimin dhe mirëkuptimin ndërfaqet. Komiteti pohon se të dhënat e tij mbi organizatat fetare lehtësojnë garantimin e lejes së qëndrimit nga policia për punonjës të huaj të organizatave të ndryshme fetare. Asnjë organizatë nuk raportoi vështirësi në marrjen e lejes së qëndrimit gjatë periudhës së raportimit. Misionarëve të huaj në përgjithësi u jepej leje qëndrimi për një vit fillimisht, në bazë të një ligji të ri që mbikqyr qëndrimin e gjithë qytetarëve të huaj, miratuar në vitin 2009. Sipas këtij ligji, shtetasit e huaj marrin leje një-vjeçare me aplikimin e parë, që pasohet nga leje dy-vjeçare. Pas kësaj, aplikantë të tillë mund të marrin leje të përhershme qëndrimi.

Sipas Ministrisë së Arsimit, shkollat publike janë shekullare dhe ligji ndalon indoktrinimin ideologjik dhe fetar. Nuk jepen mësimë feje në shkolla publike. Sipas shifrave zyrtare, komunitetet, organizatat dhe fondacionet fetare kishin 103 shoqata e fondacione të lidhura me to që menaxhonin 101 institucione arsimore, prej të cilave 15 ishin shkolla zyrtarisht me prirje fetare. Sipas ligjit, këto shkolla duhet të licensohen nga Ministria e Arsimit, dhe programi i tyre duhet të jetë në përputhje me standardet arsimore kombëtare. Grupimet katolike dhe muslimane drejtonin disa shkolla të licensuara nga shteti dhe nuk kanë raportuar probleme në marrjen e licensës për shkolla të reja. Kisha Ortodokse kishte shkolla fetare, një universitet dhe qendra arsimore për trajnimin e klerikëve. Bektashinjtë gjithashtu drejtonin qendra fetare trajnimi për klerikët.

Qeveria shënon festat e mëposhtme fetare si festa zyrtare: Pashka (Katolike dhe Ortodokse), Krishtlindja, Bajrami i Madh, Bajrami i Vogël dhe Novruzi.

Kufizime në Liritë e Fesë

Në përgjithësi qeveria ka respektuar lirinë e fesë në ligj dhe në praktikë. Nuk pati ndryshime në statusin e respektimit të lirisë së fesë nga ana e qeverisë gjatë periudhës së raportimit.

Qeveria vazhdoi të shqyrtonte pretendime nga secili prej katër grupimeve tradicionale fetare në lidhje me kthimin apo kompensimin e pronës së konfiskuar gjatë periudhës së komunizmit; megjithatë, shumë prej pretendimeve në lidhje me pronat mbetën të pazgjidhura. Me marrëveshjet dypalëshe të vitit 2008 mes qeverisë dhe grupeve mbizotëruese fetare, Agjensia Shtetërore për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave u udhëzua t'u jepte përparësi pronave të zotëruara nga komunitetet fetare, megjithëse përparimi ishte i ngadaltë.

Kisha Ortodokse vazhdoi ndërtimin e një katedraleje të re në Tiranë – parashikuar të jetë një ndër më të mëdhatë në Ballkan – mbi tokën që morri si kompensim për tokën e konfiskuar nga qeveria komuniste. Kisha citoi mungesë veprimi në lidhje me pretendime të tjera pronash në gjithë vendin dhe vërejtje se kishte një kërkesë në pritje për një kishë të re në Vlorë.

Si Kisha Ortodokse edhe Kisha Katolike përfshinë në pretendimet e tyre për kthim ikona dhe dorëshkrime të çmuara konfiskuar nga qeveria komuniste, të cilat mbetën në arkivat kombëtare.

Komuniteti Islamik Shqiptar vazhdoi të kërkonte leje ndërtimi për një xhami të re mbi tokën e kthyer këtij komuniteti gjatë procesit të kthimit të pronave pas komunizmit. Nga fundi i nëntorit, zyrtarë të bashkisë thanë publikisht se do të rregullonin kërkesat prej shumë kohësh për të ndërtuar një xhami të re pranë sheshit qendror të Tiranës. Megjithatë, deri në fund të vitit nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim formal.

Nuk ka ligje që të ndalojnë veshje apo simbole fetare. Drejtorët e shkollave kanë të drejtën të vendosin standarde për “veshje të përshtatshme”, të cilat disa herë kanë përfshirë kufizime në lidhje me shfaqjen publike të simboleve fetare. Gjatë periudhës së raportimit, pati raporte se zyrtarë të shkollave kanë ndaluar të marrin pjesë në mësim nxënës të shkollave të mesme publike që mbanin shami.

Nuk ka pasur raporte abuzimesh, përfshirë të burgosur apo të ndaluar në vend.

Seksioni III. Statusi i Veprimtarive Shoqërore që Ndikojnë në të Drejtën e Lirisë së Fesë  
Nuk ka pasur raporte abuzimesh shoqërore apo diskriminimi mbi baza përkatësie fetare, besimi apo praktimi të fesë. Nuk janë raportuar vepra të dukshme vandalizmi.

Seksioni IV. Politika e Qeverisë së SHBA

Qeveria e SHBA-së diskuton lirinë e fesë me qeverinë si pjesë e politikës së saj të përgjithshme për të nxitur të drejtat e njeriut.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës shpesh kanë përfshirë drejtues fetarë në takime, diskutime dhe ngjarje të tjera si iftar (vakte darke gjatë Ramazanit) dhe në tryeza të rrumbullakëta. Zyrtarë të ambasadës kanë qenë aktivë në nxitjen e tolerancës fetare, duke përfshirë të rinj, gra dhe anëtarë të tjerë të komunitetit në aktivitete të përbashkëta si seminare dhe takime komuniteti. Gjatë periudhës së raportimit, ambasada i zgjeroi këto përpjekje në tre shkolla publike që punojnë me medrese në vend për nisma komunitare.

Zyrtarë të ambasadës vazhduan të nxisnin qeverinë për shqyrtimin e pretendimeve për prona fetare dhe për kthimin e ndërtesave, tokave dhe prona të tjera grupimeve fetare, pasuri të cilat iu janë konfiskuar nga qeveria komuniste.